



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 6425/1 Prot.

Tiranë, më 22.09.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1408, datë 01.09.2009.

SHOQËRISË “NICKEL MINE” SH.P.K
Lagja Nr.1, Kukës.

Për dijjeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “NICKEL MINE” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1408, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektin “Mamëz”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.3659, datë 26.08.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.6425, Prot, datë 29.08.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1408, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektin “Mamëz”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar lidhur me ndërprerjen e aktivitetit minerar, ku rezulton se në objekt nuk është punuar prej më shumë se një viti kalendarik dhe subjekti nuk ka paguar garancitë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit për periudhën 2020-2021, 2021-2022.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 18, pika 1, gërma “d”, në Nenin 36, pika 1, në Nenin 47, pika 1, gërma “c”, në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1408, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektin “Mamëz”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1408, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektivin "Mamëz", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

